

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Bliana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarës E.S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1063/2016 të datës 31.08.2018, në seancë ne kolegjit të mbajtur me 10.12.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1063/2016 të datës 31.08.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar te Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1063/2016 të datës 31.08.2018 e akuzuara E.S., për shkak të veprës Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, është liruar nga akuza në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se e njëjta ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

E dëmtuara- KEDS- Distribucioni në Prizren, për realizimin e kërkesës juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit penal, më propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1170/2018, të datës 14.11.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa Prokurorisë Themelore në Prizren, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së Prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se të njëjtat shkelje konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.1 pika 1.12 të KPPK, lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, sepse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban arsye përkritazi me faktet të cilat duhet të konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara si dhe të vlerëson saktësinë e provave për të zgjedhur çështjen penale. Provat e paraqitura nga gjykata e shkallës së parë, paraqesin bazë të mjaftueshme që e akuzuara të shpallet fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPPK ngase gjykata e shkallës së parë është dashur që të njëjtat ti vlerësoj më substancialisht dhe të vie në përfundim që në veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarës janë formuar elementet inkriminuese të së njëjtës, kurse në rastin konkret rezulton se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së prokurorisë si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, ashtu që ka vlerësuar se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten dhe arsyetimin ngase nuk përmban faktet vendimtare përkritazi me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarës. Nga të gjitha provat në shkresat e lëndës, të prezantuara dhe vlerësuara në aktgjykimin e ankimuar, nuk vërtetohen elementet inkriminuese të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPPK, sepse nga deklaratat e vlerësuara rezulton se e akuzuara nuk ka qenë pronare në shtëpi, sepse të njëjtën e ka shitur. Gjithashtu kolegji ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përpiluar në kuptim të nenit 370 të KPPK, duk përmbajtur formën e kërkuar me shkrim dhe se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë të qartë se si rezultat i vlerësimit të çështjes penale si tërësi, nga faktet e prezantuara nuk rezulton se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e kjo mund të nxirret nga aktgjykimi, ku gjykata ka dhënë në mënyrë të qartë saktësinë e secilës provë për ekzistimin dhe zgjedhjen e çështjes penale, andaj pasi që nuk ka vërtetuar se e akuzuara e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, të njëjtën në mungesë të provave të njëjtën e ka liruar nga akuza.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar se kush ka qenë pronari në shtëpinë, në të cilën janë konstatuar parregullsitë të theksuara në dispozitiv të aktgjykimit, dhe nuk e ka thirrur, të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit personi E.B.A., për ta vërtetuar se i njëjti a e ka shfrytëzuar shtëpinë e të akuzuarës me qëllim që të vërtetohet se a është manipuluar njehsori i energjisë elektrike dhe se a është bërë gjatë kohës kur shtëpinë e ka shfrytëzuar e akuzuara. Gjithashtu sipas deklaratës së përbashkët të lartcekur, të lidhur në mes të akuzuarës E.S. dhe B.A. e lidhur me datën 29.04.2015, rezulton se janë bërë pagesat e duhura, mirëpo e akuzuara në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se ka dal nga shtëpia dhe pas daljes nuk merr

përgjegjësi të tjera. Nga shkresat e lëndës rezulton se kontrata te noteri është lidhur me datë 29.04.2015, dhe se ditën kritike sipas asaj që akuzohet e akuzuara kinse nuk ka qëndruar në shtëpi. Mirëpo nga të gjitha provat në mënyrë të pa dyshimtë vërtetohet se e akuzuara ka kryer veprën penale duke manipuluar njëisorin e energjisë elektrike e cila vërtetohet nga dëshmi e dëshmitarit A.B., dhe procesverbalit me nr 0175888 të datës 02.07.2015, i përpilua në vendin e ngjarjes, i cili është manipulua në brendi përreth qelqit nga ana e djathtë në të cilin është futur shiriti dhe nuk është bërë regjistrimi i energjisë së shfrytëzuar.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e prokurorisë, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarën E.S., e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPPK, në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK, sepse nga provat e procedurave nuk është mundur të vlerësohet se e njëjta ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Nga provat e procedura dhe të vlerësuara e sidomos pas leximit edhe të provave materiale, është ardhur në përfundim se e akuzuara në kohën për të cilën akuzohet se kinse ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, nuk ka qenë as pronare dhe as shfrytëzuese e shtëpisë, e cila gjendet në Rr. “ ... “ nr. 8 në Prizren, se nuk është keqpërdoruese e njëisorit të energjisë elektrike dhe se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të kundërligjshëm nga ndërmarrja KEDS-Disprubucioni në Prizren, përkundër asaj që punëtorët e KED-it përndryshe të autorizuarit për ndërrimin e njësoreve të energjisë elektrike, të njëjtit e kanë ndrruar të njëjtin por kanë deklaruar se në kohën kur i kanë marrë këto veprime nuk ka qenë prezentë e akuzuara E.S., por ka qenë personi me emër E.B.A., i cili është legjitimuar me shënimet personale nga ana e të njëjtëve dhe janë konstatuar në procesverbalin me nr. 0175888 të datës 02.07.2015, të cilët kanë theksuar se kur kanë shkuar në shtëpi e njëjta ka qenë e mbyllur dhe se personi me këto shënime eka bërë hapjen e derës së shtëpisë, andaj si rezultat i këtyre provave të vlerësuara gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur të akuzuarën e ka liruar nga fajësia për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjithashtu, sipas ankesës së Prokurorisë, aktgjykimi shkallës së parë animohet edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se pasi që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, atëherë aktgjykimi përfshihet edhe me shkelje të ligjit penale duke mos dhënë ndonjë arsye tjetër përkritazi më këtë bazë ankimore, mirëpo kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar dhe shqyrtuar të njëjtin dhe ka ardhur në përfundim se nuk përfshihet më shkeljet e ligjit penal të parapara më nenin 385 të KPPK-së, se gjykata ka vërtetuar se nuk janë formuar elementet qenësore të veprës penale, ashtu që kanë ekzistuar rrethanat që e përjashtojnë të akuzuarën nga përgjegjësia penale dhe nga ndjekja penale, se gjykata e ka aplikuar ligjin i cili është i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe ka vepruar në kuadër të kompetencë ligjore, andaj, në aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate, sepse e ka mbështetjen e duhur ligjore.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1166/2018 të datës 10.12.2018

Zyrtar ligjor
Shaban Prekalla

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq